



Mbështetur në Statutin dhe rregulloret e Universitetit AAB, Bordi i Universitetit miratoi rregulloren e mëposhtme:

Rregullore për transferimin e studentëve nga universitetet tjera në Universitetin AAB

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1.

Rregullorja për transferimin e studentëve nga universitetet tjera në Universitetin AAB (në tekstin e mëtejshëm – Rregullorja), mbështetet në Statutin dhe rregulloret e Universitetit AAB.

Neni 2.

Përmes kësaj rregulloreje, Universiteti AAB synon të rregullojë dhe të përcaktojë kushtet dhe procedurat e transferimit të studentëve nga Universitetet ose Institucionet e Arsimit të Lartë të licencuara, në Universitetin AAB.

Kushtet për Transferim

Neni 3.

Të drejtë transferimi në Universitetin AAB kanë të gjithë studentët nga Kosova dhe jashtë saj, të cilët kanë studiuar në ndonjë Universitet ose institucion të arsimit të lartë të licencuar.

Neni 4.

Studentët që duan të transferohen nga universitetet ose institucionet e tjera të Arsimit të Lartë në Universitetin AAB, duhet t'i përmbushin këto kushte:

- Të dorëzojnë dokumentacionin themelor, përfshirë këtu:
 - certifikatën e lindjes;
 - dëftesat dhe diplomën e kryerjes me sukses të shkollës së mesme;
 - dëshminë se kanë studiuar në universitetin përcjellës;
 - certifikatën e notave;
 - në rastet kur është e mundur, në certifikatën e notave duhet të jetë i përcaktuar edhe numri i kredive (ECTS) të fituara gjatë studimeve;



Neni 5.

Në fakultetet e Universitetit AAB mund të transferohen vetëm studentët nga fakultetet ose degët përkatëse të universiteteve të tjera.

Gjatë transferimit nuk mund të ndërrohet dega ose fakulteti i studimeve.

Në raste të veçanta kjo mund të bëhet me vendim të veçantë të organeve kompetente të Universitetit AAB, duke evoluuar ekuivalencën e lëndëve.

Neni 6.

Për t'u transferuar në vitin e dytë, përkatësisht të tretë të studimeve në cilindo fakultet të Universitetit AAB, studenti duhet t'i përmbushë kriteret e përcaktuara me rregulloret e Universitetit AAB, sipas të cilave studenti duhet të ketë fituar minimumin e 16 kredive nga viti paraprak.

Neni 7.

Provimet e dhëna në universitetin përcjellës njihen drejtpërdrejt në Universitetin AAB nëse janë në pajtim me planin mësimor në fuqi.

Provimet e dhëna në universitetin përcjellës, që nuk janë të përfshira në planin mësimor të Universitetit AAB, pranohen si lëndë zgjedhore.

Neni 8.

Notat e provimeve të dhëna në universitetin përcjellës përshkruhen në indeksin e studentit të transferuar në Universitetin AAB, nga dekani, ose nga Shefi i Shërbimit të Studentëve në marrëveshje me dekanin e fakultetit përkatës të Universitetit AAB.

Neni 9.

Studentët e transferuar në fakultetin përkatës të Universitetit AAB, paraprakisht duhet ta regjistrojnë semestrin vijues, në mënyrë që të fitojnë të drejtën për t'iu nënshtruar provimeve.

Neni 10.

Në rast të paqartësive, mund të kërkohet sqarim nga Zyra e Kontrollit të Cilësisë.

Dispozitat Kalimtare

Neni 11.

Të drejtën e interpretimit të dispozitave të kësaj rregulloreje e ka Sekretari i Universitetit AAB.



UNIVERSITETI - AAB
ARENA E ARSIMIT BASHKËKOHOR
PRISHTINË

Neni 12.

Kjo Rregullore mund të ndryshohet sipas procedurës së miratimit të saj.

Neni 13.

Në rast se dispozitat e kësaj Rregulloreje bien në kundërshtim me dispozitat e Statutit të Universitetit, përparësi kanë dispozitat e Statutit.

Neni 14.

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të rregulloreve të tjera që është në kundërshtim me të.

Neni 15.

Kjo Rregullore hyn në fuqi më datën e miratimit të saj nga Bordi i Universitetit AAB.

Prishtinë, 2006

Kryetari i Bordit të Universitetit

Ilir TAFA